



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

Viti mësimor 2015-2016

Faza e dytë

Klasa 11

OLIMPIADA KOMBËTARE GJEOGRAFISË

SKEMA E VLERËSIMIT

PYETJA 1

a) 3 pikë

- niveli i lindjeve
- niveli i vdekjeve
- emigracioni

b) 2 pikë

Piramida A tregon një **rritje të ngadaltë të popullsisë**. Kjo do të thotë se:

- niveli i lindjeve është i ulët
- jetëgjatësia është e lartë.
- Si rezultat popullsia është në plakje, që do thotë se përqindja e popullsisë së moshuar po rritet.

Piramida B tregon për një **rritje negative të popullsisë**.

- Niveli shumë i ulët i lindjeve (mesatarisht 1 lindje për një grua)
- Jetëgjatësia është e lartë.
- Si rezultat popullsia është në plakje, që do thotë se përqindja e popullsisë së moshuar po rritet.

c) 1 pikë

Në të dyja piramidat, popullsia është në plakje, që do thotë se përqindja e popullsisë së moshuar po rritet

d) 2 pikë

- Struktura moshore, e cila paraqitet nëpërmjet piramidës së popullsisë, ka rëndësi sepse, një popullsi e re në moshë ka nevojë për më shumë investime në shkollë, dhe pasi të shkollohen, për mundësi punësimi.\
- Ndërsa vendet që kanë një përqindje të lartë të popullsisë së vjetër, duhet të marrin masat për më shumë pensionet dhe shërbimet mjekësore. Kështu, ndërkohë që popullsia plakët nevojat shkojnë nga shkollë dhe punësimi te strehimi i të moshuarve dhe kujdesit shëndetësor.

PYETJA 2

a) 4 pikë

Arsyeja: Rënia e fertilitetit

Shpjegimi:

- Arsximimi i femrave ka bërë që ato të merren me punë më shumë se me rritjen e fëmijëve.
- Rritja e fëmijëve është e kushtueshme, normat sot janë 1-2 fëmijë.
- Kontrolli i lindjeve.
- Është krijuar një shoqëri më shumë urbane – ka më pak nevojë që fëmijët të punojnë në bujqësi.

Arsyeja: Rritja e jetëgjatësisë

Shpjegimi:

- Përmirësimi i kujdesit shëndetësor.
- Përmirësimi i stilit të jetës (njohuritë mbi rreziqet e shëndetit, dietave, ushqimit etj.).
- Ka më pak luftëra, konflikte, etj.
- Përmirësimi i kushteve të punës.
- Përmirësimi i shëndetit publik.
- Përmirësimi i standardeve të sigurisë (transporti, sportet etj).

Arsyeja: Emigrimi i të rinjve

- *Shpjegimi:*
- Për një stil më të mirë jetese.
- Për t'i siguruar të ardhura familjes etj.

Nxënësi fiton:

4 pikë nëse identifikon dhe shpjegon dy arsye

3 pikë nëse identifikon 2 arsye dhe shpjegon një të prej tyre

2 pikë nëse identifikon një arsye dhe e shpjegon atë OSE thjesht identifikon dy arsye

1 pikë nëse identifikon një arsye

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare

b)

2 pikë

- Numri i popullsisë së vjetër do të jetë më i madh se numri i popullsisë së re.
- Do të pakësohet numri i fuqisë punëtore.

Nxënësi fiton:

2 pikë nëse identifikon dy pasoja sociale

1 pikë nëse identifikon një pasojë sociale

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare

c)

2 pikë

Shtetit do t'i duhet të paguajë më shumë pensione. Do të jenë në raport të zhdrejtë numri i atyre që punojnë me ata që do të marrin pension etj.


Nxënësi fiton:

1 pikë nëse identifikon pasojën ekonomike

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare

PYETJA 3

- a) Në Tropikun e Jugut **1 pikë**
- b) Në Hemisferën e Jugut **1 pikë**
- c) Në Ekuator **1 pikë**
- d) Në Polin e Jugut **1 pikë**



e) Në Polin e Veriut

1 pikë

Pikët për figurën

1 pikë për vizatimin e saktë të paralelit ku bien pingul rrezet e Diellit

1 pikë për vizatimin e saktë të boshtit të Tokës

1 pikë për vizatimin e saktë të kufirit midis ditës dhe natës

PYETJA 4

a) Hartë topografike

1 pikë

b) Lumi rrjedh më shpejt në pikën 1

1 pikë

Argumenti

c) Izohipset në pikën 1 janë më të dendura. Sa më të dendura të jenë izohipset, aq më e madhe është pjerrësia e relievit.

1 pikë

PYETJA 5

a) Klimë më të ngrohtë ka qyteti i Londrës.

1 pikë

b)

➤ Rrymat e ngrohta oqeanike ndikojnë në zbutjen e klimës në Londër.

1 pikë

➤ Vendndodhja e Londrës më pranë oqeanit, bën që rrymat të kenë ndikim më të madh në ngrohjen e klimës. Irkutsk gjendet më në brendësi të kontinentit krahasuar me Londrën.

1 pikë

PYETJA 6

Fillimisht gjejmë ndryshimin midis kohës lokale të Ankarasë dhe asaj të Tiranës.

4 pikë

$12h52' - 12h = 52min$

Për 4 min $\longrightarrow 1^{\circ}$

Po për 52' $\longrightarrow X$

$X = 52 * 1/4 = 13^{\circ}$

Pra ndryshimi i gjatësisë gjeografike është 13°

Por meqë koha lokale e Ankarasë është më përpara se ajo e Tiranës (meqë Ankaraja ndodhet më në lindje të Tiranës) duhet që gjatësisë gjeografike t'i shtojmë 13° .

$20^{\circ} + 13^{\circ} = 33^{\circ}$ gjatësi gjeografike lindore.

PYETJA 7

a) Vizatimi i saktë i sistemit diellor:

- Renditja e saktë e planetëve.

1 pikë

- Vendosja e brezit të asteroideve midis orbitave të Marsit dhe Jupiterit.

1 pikë

b) Numri i planetëve i pranuar sot është 8, pasi që prej viti 2006, shkencëtarët nuk përfshijnë më si planetin e nëntë të sistemit tonë diellor Plutonin, për shkak të përmasave të tij shumë të vogla.

1 pikë

c) Janë 5 planetë xhuxh (Ceres, Makemake, Haumea, Eris, Plutoni).


2 pikë

d) Afërdita dhe Urani.

2 pikë

e) Mërkuri, i cili e ka ditën 58d 15h e 30m, ndërsa viti është 88 ditë.

1 pikë



- f) Një trup do të peshonte më pak në Hënë për shkak se Hëna ka një forcë rëndese më të vogël, për këtë arsye do ta tërhiqte trupin drejt sipërfaqes së saj me një forcë më të vogël. Duke qenë se forca e rëndesës së Hënës është sa $1/6$ e forcës së rëndesës së Tokës ky trup në Hënë do të peshonte 10 kg. **2 pikë**

PYETJA 8

- a) Për të krijuar hartat përdoren disa lloje projeksionesh hartografikë. Konkretisht, në këtë hartë është përdorur projeksioni Merkator, i cili ruan formën e kontinentit por shformon sipërfaqet. Madje, shformimi i sipërfaqeve është më i madh, sa më larg ekuatorit të jenë sipërfaqet tokësore. Për këtë arsye, Groenlanda, që ndodhet në gjerësi të mëdha gjeografike ka shformim më të madh se Australia që ndodhet në gjerësi të vogla gjeografike. **5 pikë**
- b) Zakonisht në shkolla përdoren harta, në të cilat aplikohet projeksionin Robinson, sepse ky lloj projeksioni nuk jep shformime ekstreme të sipërfaqes. **1 pikë**